REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. Prot. **Bilisht më . . 2025**

PROJEKT-VENDIM

NR 2, DATË 21 / 01 /2025

"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT NË BASHKINË DEVOLL PER VITIN 2025"

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar nenit 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24, të ligjit Nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar neni 2 pika 51, VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënjes së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr. 384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM Nr.522 datë 25.07.2019 "Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira", VKM Nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit si dhe kushtet e standarte për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", Udhëzimit Nr. 23 datë 30.12.2008 "Për përmbajtjen e bonusit të strehimit", si dhe VKB Nr. 69 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025".

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Rregullores për Komisionin e Strehimit në Bashkinë Devoll për vitin 2025.
2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet komisioni i strehimit.
3. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 4 date 29.01.2024, shfuqizohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar

Konceptoi: Specialiste për administrimin e nevojave për strehim
Linda Laçi
Konfirmoi: Përgjegjësi sektorit të Kujdesit Social
Marilda Bejleri
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale, Shëndetësore dhe Strehimit
Zerina Sinani
Konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Eriksela Aydo

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Vetori Nr. 9; Tel+35558122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; eeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr.201 Prot. **Bilisht më, 21.01.2025**

RELACION

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KOMISIONIT TË STREHIMIT

(PËR NDYSHIMIN E DISA ANËTARËVE NË KOMISIONIT E STREHIMIT).

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore "neni 8 pika 2 i cili shprehimisht thotë:
Organet e njësive të qeverisjes vendore ushtrojnë kopetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhërave
- neni 9 pika 1.1/a dhe 1.1/5 i cili shprehimisht thotë:
Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes sipas së cilës:
a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave
- neni 30 pika 7 i cili shprehimisht thotë:
Të drejtën e bashkëpunimit sipas së cilës:
Për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund te ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të vecanta njëra – tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë dhe në zbatim të Ligjit Nr.22/2018 "Për Strehimi Social". Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton gjithashtu dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë si dhe të njësive të institucioneve buxhetore në vartësi të bashkisë.
Sipas udhezimeve të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë për bashkitë e vendit do të funsionojë sistemi kompjuterik on-line i hedhjes së të dhënave të aplikantëve për programet e strehimit, duke përdorur një sistem softuerik "FortiClient VPN" i cili ofron një sërë veçorish duke përdorur kriptim IP sec dhe SSL optimizim ËAN, pajtueshmëri në pikën përfundimtare për vërtetim me dy faktorë.
Entet menaxhuese në qytet, që kanë treg banesash me qira në bazë të vendimit të këshillit bashkiak i japin familjes që përfiton nga banesat sociale me qira, të cilat plotësojnë kushtet të përcaktuara në nenin Nr.36 "Subvencionimi i qirasë për banesat në pronësi të pronarit social" kur:
a) Nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.

b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 36 bëjnë përjashtim nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë se:

a)familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira , e cila ndodhet pranë vendit të punës, shkollës së fëmijëve, qëndrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera:

b) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është sipas pikës 5, të nenit 30 të këtij ligji.

Neni 15

Rregulla të përzgjedhjes përmes sistemit të pikëzimit

1.Përzgjedhje e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike para fillimit të proçesit.

2.Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.

3.Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 34

Rregulla e përgjithshme mbi subvencionimin e qirasë

3.Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme:

a) Individët me status jetimi
b) personat me aftësi të kufizuar
c) të moshuarit
ç) invalidët e punës
d) familjet e policëve të rënë në detyrë
dh) emigrantët e rikthyer
e) punëtori emigrant
ë) azilkërkuesit
f) familjet e komunitetit rom
g) familjet e komunitetit egjiptian
h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimt:
i) prindërit e vetëm që kanë në ngarkim fëmijë
j) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktima për shkak të orientimit seksual ose inditetit gjinor bazuar në vendimin e organit kopetent, sipas legjislacionit në fuqipër mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasoje e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhuara të

pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.
k) të miturit, 14-18 vjeç dhe të rinjtë 18 – 21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më mirë në shoqëri:
1) vajzat nëna, pas nga programi i banesave sociale të specializuara:
11) familjet me statusin e qiramarësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr.3, datë 01.03.2012. Radha e përparësisë së këtyre kategorive përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Entet menaxhuese në qytet, që kanë treg banesash me qira në bazë të vendimit të këshillit bashkiak i japin familjes që përfiton nga banesat sociale me qira, të cilat plotësojnë kushtet të përcaktuara në nenin nr. 36 "Subvencionimi i qirasë për banesat në pronësi të pronarit social"
a) Nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.
b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave.
Në zbatim të pikës 2 të nenit 36 bëjnë përjashtim nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë se:
a) familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira, e cila ndodhet pranë vëndit të punës, shkollës së fëmijëve, qëndrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera:
b) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është sipas pikës 5, të nenit 30 të këtij ligji.

Neni 33

1.Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira që ndihmon individët /familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose qirasë reale.
2.Masa e subvencionimt është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes.Subvencionimi mund të mbulojë deri 100 % të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë dhe që strehohen në banesa sociale me qira.
Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr.22/2018 "Për Strehimi Social", VKM nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët.

Përparësi në subvencionimin e qirasë, sipas sistemit të pikëzimit, kanë por pa u kufizuar në to, kategoritë e përcaktuara në nenet 33 dhe 34/3 të ligjit nr. 22/ 2018 "Për Strehimin Social" përfshirë individët, që dalin nga sistemi i përkujdesjes alternative si individët me statusin e jetimit, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit, invalidët e punës, familjet e policëvë të rënë në detyrë, emigrantët e rikthyer, punëtori emigrant, azilkërkuesi, familjet e komunitetit rom, familjet e komunitetit egjiptian, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, prindërit e vetëm që kanë në ngarkim fëmijë, individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të miturit 14 – 18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç në

konflikt me ligjin, vajzat nëna, pas daljes nga program i banesave sociale të specializuar, familjet me statusin e e qiramarësit, në banesave ish-pronë private, sipas Aktit Normativ me Fuqinë e Ligjit nr.3, datë 01.03.2012. Në bazë të Vendimit nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë të tregut të lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij pika 4, njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vlerën konkrete të subvencionit të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social në tregun e lirë bazuar në:
a) vlerën mesatare të në tregun e lirë, e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane e rurale të një njësie të vetëqeverisjes vendore
b) të ardhurat familjare, sipas kategorizimit të pikës 44, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018:

Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK

Marilda Bejleri

BASHKIA DEVOLL

RREGULLORE

"PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT NË BASHKINË DEVOLL

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është krijimi i një kuadri rregullator për mënyrën e përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit, për një veprimtari më eficente dhe transparente ndaj të tretëve, të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë. Ky komision në përputhje me normat juridike, duhet që sa herë në Bashkinë Devoll ka në zbatim një program social strehimi, të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin për të bërë të mundur, vlerësimin teknik sipas sistemit të pikëzimit të miratuar në Këshillin Bashkiak, të listës emërore të personave aplikues, me qëllim sigurimin e transparencës dhe eficencës së tij si organan kolegjial përballë aplikuesve.

.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore bazohet në:
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 24, neni 54 gërma "k"
Ligjin 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar
Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave i Republikës së Shqipërisë"
VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së Subvencionit të Qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e Qirasë në tregun e Lire, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, dhe mënyrën e Llogaritjes së Tij"
VKM Nr. 384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas cdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e Vetëqeverisjes Vendore"
Çdo ligj, Vendim, Udhezim apo Akt Normativ që rregullon.

Neni 3

Parimet mbi të cilat funksionon Komisioni

Parimi i Ligjshmërisë: Komisioni i strehimit ushtron funksionet në përputhje me Kushtetutën dhe Legjislacionin në Republikën e Shqipërisë.

Parimi i Transparencës: Komisioni i strehimit ushtron veprimtarine administrative në mënyrë transparente për të gjithë aplikantët dhe qytetarët e Bashkisë Devoll.

Parimi i Drejtësisë dhe i paanësisë: Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni i strehimit trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanëshme të gjitha dosjet e aplikantëve.

Parimi i Objektivitetit: Gjatë ushtrimit të procedurës administrative, Komisioni i strehimit, ka detyrimin të marrë në konsideratë dhe ti japë rëndësinë e duhur të gjithë dokumentacionit të dorëzuar si dhe të bëjë verifikimin e kushteve dhe të dhënave që lidhen me këtë procedurë administrative.

Parimi i Përgjegjesisë: Anëtarët e Komisionit të Strehimit, kur kryejnë një procedurë administrative mbi pikëzimin e listës të aplikantit për një nga programet sociale të strehimit, mbajnë përgjegjësi në përputhje me legjislacionin përkatës.

Parimi i Barazisë dhe Mosdiskriminimit: Komisioni i strehimit gjatë procedurës administrative, ka detyrimin ligjor që për palët që janë në situate të njëjta objektive, ti trajtojë në mënyrë të barabartë. Komisioni ka detyrimin që në zbatim të dispozitave ligjore të shmangë cdo diskriminim që ka të bëjë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, orientimin seksual, bindjet politike apo fetare, gjendjen ekonomike, arsimore, sociale etj.

Neni 4

Organizimi dhe përberja e Komisionit të Strehimit

1. Komisioni i strehimit do të përbëhet nga 8 (tete) anëtarë me të drejta të plota, ku njëri prej tyre do të jetë në cilësinë e Kryetarit, anëtarët dhe sekretari.
2. Në përbërje të tij duhet të kete anëtarë me profesion ekonomist, jurist, arkitekt/ Inxhinier Ndërtimi të cilët janë nëpunës Civil pranë Bashkisë Devoll dhe anëtarë, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse me aktivitet në juridiksionin e Bashkisë Devoll.

Komisioni përbëhet nga:

- Drejtor i Shërbimit Social - Kryetar komisioni.
- Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit -Anëtar komisioni
- Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK -Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit - Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve - Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i Emergjencave Civile - Anëtar komisioni
- Specialist i administrimit për nevojat për Strehim - Anëtar komisioni
- Përfaqësues nga Shoqata e Romëve - Anëtar komisioni

Neni 5

Kompetencat e Kryetarit të Komisionit

1. Drejton mbledhjen e anëtarëve të Komisionit të Strehimit.
2. Cakton datën, vendin dhe orën e mbledhjes së komisionit.
3. Miraton rendin e ditës dhe në përputhje me të cakton detyrat për cdo anëtar.
4. Miraton vendimet e takimit dhe harton relacionin për Keshillin Bashkiak.

Neni 6

Detyrat e sekretarit të Komisionit

1. Sekretari ka për detyrë:
   - Të verë në dijeni anëtarët për datën, vendin dhe orën e mbledhjes së rradhës së komisionit.
   - Të përgatisë materialin e mbjedhjes dhe t'ua shpërndaje atë anëtarëve, minimumi pesë ditë para datës së caktuar të mbledhjes.
   - Të mbajë proceverbalin e mbledhjes dhe ta firmosë atë nga cdo anëtar.
   - Të përgatisë relacionin dhe t'ia paraqesë atë për miratim kryetarit të Komisionit.
   - Të ngrejë probleme, të cilat kanë nevojë për t'u adresuar nga Komisioni i Strehimit.

Neni 7

Funksionimi i Komisionit të Strehimit

1. Komisioni i Strehimit kryesohet nga kryetari.
2. Kryetari i Komisionit miraton rendin e ditës të propozuar nga sekretari i Komisionit të Strehimit.
3. Mbledhja e Komisionit si rregull mbahet jo më pak se 1 herë në muaj. Me kërkesë të kryetarit ose disa prej anëtarëve, komisioni mund të mblidhet edhe jashtë rradhe.
4. Pesë ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes, bëhet njoftimi i anëtarëve të komisionit, si dhe shpërndahet programi dhe materiali që do të shqyrtohet nga komisioni.
5. Komisioni zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm me 3/5 e anëtarëve të tij.
6. Komisioni shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin e dorëzuar dhe vendos piket, sipas sistemit të pikëzimit, të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Neni 8

Detyrat dhe kompetencat e Komisionit të Strehimit

1. Sektori i strehimit pas seleksionimit të formularëve të vlefshëm i kalon këto të fundit për shqyrtim Komisionit të Strehimit të miratuar nga Keshilli Bashkiak.
2. Komisioni i Strehimit vendos pikët sipas sistemit të pikëzimit të miratuar me VKB.
3. Komisioni i strehimit, sa here që në Bashkinë Devoll zbatohet një program strehimi, sipas ligjit Nr.22/2018 "Për Strehimin Social" I ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim te tij, mer në shqyrtim të gjitha aplikimet dhe dokumentacionin e plote të aplikuesve që kanë aplikuar pranë Bashkisë Devoll.
4. Komisioni i strehimit shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin brenda 10 (dhjete) ditëve nga data e marrjes në dorëzim të formulareve të aplikimit nga zyra përkatëse e njësisë së qeverisjes vendore (Sektori i Mirëqenies dhe Kujdesit Social) dhe

vendos pikët për secilin aplikues, sipas sistemit të pikëzimit të programit përkatës të miratuar nga Këshilli i Bashkisë.

5. Komisioni i Strehimit harton listën e familjeve përfituese mbështetur në klasifikimin e kërkesave, e cila pasi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të komisionit i paraqitet Sektorit të Mirëqënies dhe Kujdesit Social
6. Kryen dhe çdo detyrë tjetër që parashikohet shprehimisht në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e strehimit.
7. Kjo listë miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak dhe më pas publikohet.

Neni 9

Njohja me Rregulloren

Të gjithë anëtarët e Komisionit të Strehimit kanë detyrimin ligjor të njihen dhe të zbatojnë këtë rregullore.

Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Komisioni i Strehimit.

Hartoi: Pergjegjes i Sektorit Juridik dhe Prokurimit Publik

Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL